

PREZANTOHET PROJEKTI MODEL I SERRËS SË PERIMEVE DHE I PEMISHTES SË MOLLËS

Nga kultivimi tradicional drejt atij intensiv

Mitrovicë, 25 qershor

Iniciativa Për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK), në prani të zyrtarëve të lartë të EURED-it, AZHRV-së, zyrtarëve komunalë dhe përfaqësuesve të disa bizneseve, të shtunën i ka prezantuar dy njësi demonstruese në kuadër të projektit që po e realizon në rajonin e Mitrovicës, mbështetur nga EURED-i, që do zgjasë 22 muaj dhe që ka kosto prej 383 mijë nga gjithsej 447 mijë euro. Para zyrtarëve të lartë të këtyre organizmave u prezantua modeli i serrës së perimeve, e ndërtuar në Çabër të Zubin Potokut dhe ai i pemishtes së mollës, i ndërtuar në Vaganicë të Mitrovicës.

Sipas praktikave të BE-së

Objektivat e projektit, sipas Zenel Bunjakut, drejtor ekzekutiv i IADK-së, synojnë të kontribuojnë në arritjen e standardeve të BE-së në sektorin e Bujqësisë në rajonin e veriut të vendit, për të ofruar siguri për konsumatorët se prodhimet bujqësore plotësojnë kriteret e cilësisë sipas praktikave të BE-së. Bunjaku me këtë rast u shpreh se u promovua zhvillimi i pemishtes model në fshatin Vaganicë të Mitrovicës dhe serra në Çabër të Zubin Potokut. "Po promovojnë ndryshimet që po bëjmë në sektorin e bujqësisë, duke ndryshuar qasjen nga kultivimi tradicional në kultivimin intensiv me përdorimin e teknikave dhe teknologjive të reja si dhe metodave të reja të dhënies së këshillave për fermerët tanë. U jemi mirënjohës Bashkimit Evropian për ndihmën, komunave dhe fermerëve për guxim dhe tyre për kalimin nga forma tradicionale në kultivimin intensiv të kulturave bujqësore", tha Bunjaku. Brian Mekarti, përfaqësues i Asistencës Teknike të EURED-it, i cili ishte prezent, po ashtu shprehu kënaqësinë për këtë projekt. "Unë shoh



Realizohet projekti i pemishtes me 2 mijë e 100 fidanë të mollës

punë të mbarë këtu dhe shpresoj se këto pika demonstruese do të ndihmojnë fermerët të zhvillojnë kultivimet sipas praktikave më të mira dhe të bëhen konkurrentë me produkte bujqësore, ashtu siç po ndodh në Irlandë e gjetiu në Evropën Perëndimore".

"Projekti "Promovimi i bujqësisë-hortikulturës, blegtorisë dhe përpunimit të frutave në rajonin e Mitrovicës" është mbështetur nga zyra ndërlihdhëse e Komisionit Evropian dhe synon krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e agrobiznesit", tha drejtori ekzekutiv i IADK-së, Zenel Bunjaku



Modeli i serrës së perimeve e ndërtuar në Çabër të Zubin Potokut

Nga serra pritet të prodhohen 15 deri 20 tonë domate

Fal punës së fermerëve dhe ekspertëve të IADK-së, serra e perimeve dhe pemishtja janë shembull e zhvillimit të qëndrueshëm në agrobiznes. Në Çabër të Zubin Potokut përfutuesi i serrës së perimeve, Ahmet Uka, kishte nisur punën me kultivimin e perimeve në një serë të vogël me pak kushte, ndërsa tash kishte një sipërfaqe të madhe me perime dhe serra. "Ne kemi kultivuar perime në serra të ndërtuara për konsum të familjes, por me ndihmën e IADK-së dhe Bashkimit Evropian ne sot kemi serrë model më sipërfaqe prej 500 m² me rreth 1 mijë e 500 fidanë të llojeve të ndryshme të domates, të cilat ujiten me sistemin me pika uji dhe presim që të furnizojmë tregun me një prodhim që parashihet prej 15 deri 20 tonë domate", shtoi Uka i cili nuk ka hezituar të tregojë për punën dhe vështirësitë që ka pasur, ndërkohë që tash, fal mbështetjes dhe bashkëpunimit në serën e tij, ka një gjendje shumë të mirë të domateve, edhe pse ai i ka mbjellë edhe të gjitha llojet e tjera të perimeve. Pranë shtëpisë së Sylejman Shalës nga Vaganica ishte ngritur një plantacion i madhe me fidanë

të mollës, ndërsa sistemi ujitës me pika kishte dhënë rezultate për gjendjen e mirë të pemëve, ndonëse ajo ishte ngritur vetëm 4 muaj më parë. "Shumë pak njerëz kanë besuar në pemishte në këtë hapësirë, por me këshillat dhe ndihmën e IADK-së ne kemi marrë guximin të fillojmë projektin e pemishtes me 2 mijë e 100 fidanë të mollës (Pink Lady, Delishes, Klona B, Gala dhe Starking), e cila është duke u zhvilluar mirë. Tani pemishtja jonë është shkollë për fermerët që të mësojnë për kultivimin intensiv të mollës. U jemi mirënjohës IADK-së, komunave dhe Bashkimit Evropian për ndihmën", shtoi Shala. I pranishëm në këtë prezantim ishte edhe nënkryetari i Mitrovicës, Riza Haziri, i cili dukshëm i kënaqur nga këto projekte shprehu angazhimin e Komunës për të bashkëpunuar dhe bashkëfinancuar projekte të cilat janë të qëndrueshme dhe ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve. Komponentët e projektit janë: Agjencitë për Zhvillim Rajonal, skemat e granteve dhe asistencë teknike. Në nëntor të vitit 2010 Komisioni Evropian ka dhënë 7.4 milionë euro për aplikantët e skemës së parë të EURED-it, nga e cila IADK ka fituar 383,682.14 euro. F. BEKA